



Prof. Dr. Endri PAPAJORGJI është jurist, avokat, ekspert ligjor dhe pedagog i mirënjohur në fushën e së drejtës e me një eksperiencë mbi 15 vjeçare. Prof. Endri Papajorgji ka mbaruar studimet e larta (Bachelor-Master-PhD) në Drejtësi pranë “Karl Franzens Universität Graz”, Austri dhe ka fituar titullin akademik “Profesor i asociuar” nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në maj të 2015. Në qershor 2022 ka fituar titullin akademik “Profesor Doktor”.

Prof. Endri Papajorgji ka kryer punë kërkimore shkencore në Universitetin e Graz-it, Maribor-it, Vjenës, Leuven-it, Salzburg-ut, Zagreb-it, Ljubljanes, Mynih-ut, Regensburg-ut, Shkup-it, Tetovës, Prishtinës etj, si dhe pranë Institucioneve të BE-së në Bruksel dhe Luksemburg. Prof. Endri Papajorgji ka punuar si jurist, konsulent dhe avokat pranë disa zyrave ndërkombëtare dhe lokale ligjore (Vjenë, Graz, Tiranë), si dhe punon si lektor i jashtëm pranë Universitetit “Karl Franzens Universität Graz” Austri si dhe pedagog në disa Universitete publike dhe private në Shqipëri.

Prof. Endri Papajorgji është zgjedhur Dekan i Fakultetit të Drejtësisë i Tirana Business University që prej vitit 2014 dhe Zv. Rektor që nga Tetori 2015. Ka qenë pjesë e dhjetra grupeve të punës në kuadër të hartimit të legjislacionit në fushën e së drejtës dhe arsimit.

Prof. Endri Papajorgji është emëruar Këshilltar Kabineti më prill 2022 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Prof. Endri Papajorgji ka publikuar 8 libra shkencorë, 2 prej të cilëve në Gjermani dhe 6 në Shqipëri. Ai ka publikuar mbi 140 artikuj shkencorë në konferenca e revista shkencore ndërkombëtare me një total prej më shumë se 5000 faqe në formën e monografive shkencore, artikujve shkencore, teksteve mësimore, botime në proceedings me ISBN dhe ISSN, kapituj librash, opinione e draftime ligjore, etj.

Prof. Endri Papajorgji është Anëtar i Dhomës Kombëtare Shqiptare të Avokatisë, Anëtar i Dhomës Kombëtare Shqiptare të Ndërmjetësimit, Drejtor Ekzekutiv i Institutit Ndërkombëtar për të Drejtën Private, Tregtare dhe Konkurrencës, Anëtar i Alumni Uni Graz Network, Kryeredaktor i Revistës ndërkombëtare shkencore “Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences”, Kryeredaktor i Revistës ndërkombëtare shkencore “Balkan Journal of Interdisciplinary Research”, Anetar bordi i “Albanian Social Economic Review”, etj.

Publikimet e tij përfshijnë këto monografi e tekste mësimore:

1. Ausgewählte Kapitel des Strafrechts in Albanien, Dr. Müller Verlag (2010) (100 faqe) (Monografi) (ISBN: 9783639302080).
2. E drejta europiane private, ILAR (2012) (210 faqe) (ISBN: 9789928107602).

3. E drejta ndërkombëtare tregtare dhe e biznesit, ILAR (2012) (250 faqe) (ISBN: 9789928107619).
4. E drejta ndërkombëtare private, ILAR (2013) (320 faqe) (ISBN: 9789928107886).
5. Privatisierung von Unternehmen in Albanien und Mazedonien im Rechtsvergleich, Saarbruecken Verlag der Rechtswissenschaften (2013) (Monografi) (376 faqe) (ISBN: 9783861941231).
6. E drejta ndërkombëtare dhe shqiptare e konkurrencës ILAR (2014) (250 faqe) (ISBN: 9789928419538).
7. Privatizimi në Shqipëri (Monografi) (2015) (150 faqe) (9789928428431).
8. E drejta e konkurrencës-Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare, (2016) (190 faqe) (ISBN: 9789928214119).